



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 32-të të KPF-së e mbajtur, më 02.06.2021, në sallën e kuvendit, me fillim në ora 13⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Hyra Bytyçi, anëtare
3. Lumturije Bytyqi-Hasani
4. Albulena Kelmendi, anëtare
5. Ukë Kryeziu, anëtar
6. Afrim Miftari, anëtar
7. Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Sefer Tasholli, DGJK
2. Bekim Shabani, DEZH
3. Emina Rexhiq, DPU
4. Kimete Jashanica, OSBE

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha rendin e ditës e keni marrë dhe të njëjtin e lexoi në vazhdim.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 31 – të.
2. Propozim Vendim për lirim nga pagesa e taksave komunale .

3. Propozim Vendim për shpalljen e interesit publik për shpronësim të paluajtshmërive në funksion të ndërtimit të segmenteve rrugore " Afrim Zhitia " , " Mbreti Zog " dhe " Kongresi i Blinajës " në Lipjan .
4. Propozim Vendim për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Lipjanit 2021-2029 .
5. Propozim Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit .

Pastaj Kryesuesi pyeti a ka vërejtje apo plotësime rreh rendit të ditës?

Lumturije Btyqyi-Hasani,unë e kam një propozim qe të jetë pikë shtesë propozim vendimi për zgjedhjen e këshillave të fshatrave i cili ka mbet në gjysme, po ashtu edhe propozimi tjetër qe të zëvendësohet anëtari i komisionit nga ekzekutivi.

Daut Azemi,ne do ta kemi edhe një mbledhje prapë në qershor dhe do të jetë kjo pikë, por do të bisedoj me zyrën ligjore do të shohim a është e mundur qe te përgatitet për këtë mbledhje.

Pasi që nuk pati propozime tjera kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja për punën e kësaj mbledhje me të gjitha votat, 7 për, aprovoi:

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 31-të e KPF-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 31-të të KPF-së

Shtesë: Ekstrakti

Pastaj u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës

II

Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Mars 2021

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, tha se kjo pikë propozoj që të shkon direkt për kuvend

Pastaj Kryesuesi vuri në votim propozimin që të kaloj direkt në kuvend, me të gjitha vota për kaloi kjo pikë..

Pastaj u kalua në pikën në vazhdim

.

III

Propozim Vendim për shpalljen e interesit publik për shpronësim të paluajtshmërive në funksion të ndërtimit të segmenteve rrugore “ Afrim Zhitia ” , “ Mbreti Zog ” dhe “ Kongresi i Blinajës ” në Lipjan .

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, ia dha fjalën, Sefer Tashollit , drejtor i DGJK, e cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Afrim Miftari, e falënderoj drejtorin për sqarimin që e beri, por nëse ka mundësi edhe një sqarim shtesë të rruga “Afrim Zhitija” në cilën pjesë do të jetë.

Lumturije Bytyqi-Hasani, kemi të bëjmë me një propozim vendim që janë 3 rrugë për shpronësim, dhe ky ekzekutiv ka ardh në pushtet duke e kritikuar pushtetin e kaluar për shpronësim. Kryetari publikisht ka thënë disa mbledhje të Kuvendit se unë nuk jepi parë për shpronësim dhe fjala publike duhet të mbahet. Unë do të votoj kundër këtij propozimi.

Sefer Tasholli, rruga “Afrim Zhitija” do të jetë nga rruga autostradës deri te Konjuhi që me herët është njohur si rruga e arave.

Ukë Kryeziu, te rruga “Kongresi i Blinajës” te shpronësimi thuhet se është pronë shoqërore e dhënë për 99 vite.

Lumturije Bytyqi-Hasani, kompensimi kujt do të bëhet këtu pronarit apo AKP-s?

Albulena Kelmendi, unë po e kam pak problem pak me e kuptua qysh mundet prona shoqërore me u shpronësuar, dhe çka do të ndodhë me këto prona pas 99 viteve. Unë do të votoj që kjo pike të shkojë për kuvend, ndërsa qëndrimet tona si grup do t'i japim në mbledhjen e kuvendit.

Sefer Tasholli, kompensimi do t'i bëhet pronarit, ndërsa sa i përket çka do të ndodhë me pronat për 99 vite që janë dhënë në shfrytëzim, ndoshta kuvendi do t'i ndryshoj ligjet deri në atë kohë.

Daut Azemi, Komuna i jep në shfrytëzim pronat ndërsa AKP-ja i shet për 99 vjet.

Mëqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 6 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

IV

Propozim Vendim për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Lipjanit 2021-2029

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i a dha fjalën, Emina Rexhiq drejtoreshë e DPU, e cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin.

Lumturije Bytyqi-Hasani, se pari unë nuk kam mujt sa duhet me shiku këtë material pasi që ka ardhë me vonësë dhe duhet që të respektohet 7 ditë të punës sipas rregullores së punës së kuvendit. Ne si grup i PDK-s kemi dhënë qëndrimet tona por janë marrë pjesërisht.

Daut Azemi, do të bëjë përpjekje që të ju vijë materiali ashtu siç ceket në rregullore, dhe nuk e kam ditë që ju ka ardhë në mënyrë fizike një ditë me vonë se ajo elektronike po ka qenë shumë material dhe është dashtë punë.

Albulena Kelmendi, edhe nuk kam mujt me e shfletua këtë material pasi që është vulominoz dhe ka qenë kohë e shkurtër por do të bisedojmë me ekspertet tonë dhe do t'i japim qëndrimet tona në kuvend.

Kam një këshillë për ekzekutivin që mos të bëhet kopje materiali siç po bëhet tani por të ju dërgohet vetëm në mënyrë elektronike anëtarëve të kuvendit e jo siç po veprohet deri tani.

Daut Azemi, unë kam pas një takim me shefat e grupeve parlamentare për këtë çështje, por me rregullore ne jemi të obliguar që të dërgojmë materialin edhe në mënyrë fizike, por duhet që kushdo që të vijen kryesues i ardhshëm i Kuvendit ta ndryshoj rregulloren e punës së kuvendit.

Hyra Bytyçi, e falënderoj drejtoreshën për sqarimin që na e bëri ne si grup e përkrahim por kam një pyetje. A ka pas ankesa të pa bazuara rreth hartave zonale?

Afrim Miftari, e falënderoj drejtoreshën për sqarim që e bëri, kam një pyetje rreth koeficientit qysh do të jetë në Lipjan.

Lumturije Bytyqi-Hasani, rreth kishës në Lipjan është zonë e mbrojtur dhe ndalohet ndërtimi si do të veprohet në atë pjesë.

Emina Rexhiq, te kisha lejohet ndërtimi deri në 4 kat, po ashtu do të lejohet edhe BIK-ut në Lipjan që të ndërtojnë në pronën e tyre të cilën që sa kohë nuk kanë mujt me ndërtu. Aty te kisha është një rreze prej 50 m ku do të lejohet ndërtimi. Ndërsa për koeficientin do të ju tregojmë në kuvend.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

V

Propozim Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit .

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i dha fjalën, Bekim Shabanit drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim rregullorja.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani, e kam shqyrtua këtë propozim vendim por kam një propozim është dashtë që të specifikohet se me çfarë veprimtarie merret kjo ndërmarrje me çfarë lloji të produktit. Dhe a është e lejime me kanë vetëm një ofertues sipas ligjit.

Berkim Shabani, kjo do të merret me punimit e materialit për pishina për ballkone e tjera. Po lejohet sipas ligjit vetëm një ofertues.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të 7 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 14,³⁵

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Daut Azemi